

Buletini i Lajmeve të Sigurisë Kibernetike

Tetor 2022

AKCESK MERR PJESË NË KONFERENCËN: "SHOQËRITË DIGJITALE: PËRVOJA ESTONEZE NË SHQIPËRI"



Autoriteti Kombëtar për CESK mori pjesë në konferencën "Shoqëritë digjitale: Përvoja Estoneze në Shqipëri". Në këtë event u diskutua çështja e rëndësishme e digjitalizimit në Shqipëri.

Në konferencë morën pjesë gjithashtu edhe disa nga institucionet kombëtare me impakt në digjitalizim, si edhe studentë e dashamirës të tjerë të digjitalizimit në shërbimet publike dhe veçanërisht në sektorin financiar.

Autoriteti Kombëtar për CESK në këtë event, prezantoi kuadrin rregullator për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara, i cili është në linjë me BE dhe ka për qëllim rritjen e përdorimit të sigurt të shërbimeve publike, si edhe mundësinë e zgjerimit të shërbimeve të sigurta nga sektori privat.

AKCESK NË PARTNERITET ME PREZENCËN E OSCE NË SHQIPËRI ORGANIZUAN FUSHATËN E NDËRGJEGJËSIMIT MBI KËRCËNIMET KIBERNETIKE



Në kuadër të Muajit të Ndërgjegjësimit për Sigurinë Kibernetike, nga 19 tetori deri më 2 nëntor 2022, AKCESK u takua me fëmijë, prindër, mësues, psikologë dhe punonjës socialë në shkolla për të rritur ndërgjegjësimin e komunitetit për kërcënimet kibernetike. Sesionet informuese, të zhvilluara në Korçë, Pogradec, Shkodër Malësi e Madhe, Rrëshen dhe Lezhë, synuan gjithashtu, t'i ndihmonin të rinjtë të mbrohen online, ndërkohë që kërcënimet ndaj teknologjisë dhe të dhënave personale bëhen gjithnjë e më të zakonshme. AKCESK i organizoi këto sesione informuese në partneritet me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri.

KONTAKT

Rr. "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë Albania 04-22-21039

Email: info@cesk.gov.al

Web: www.cesk.gov.al



AKCESK vijon fushatën e Mbrojtjes së Fëmijëve në Internet me mbështetjen e International Telecommunication Union

Në kuadër të Tetorit- Muajit Europian për Sigurinë Kibernetike, Autoriteti Kombëtar për CESK në bashkëpunim me International Telecommunication Union ka hartuar mesazhin e unifikuar lidhur me Mbrojtjen e Fëmijëve në Internet.

Mesazhi i unifikuar paraqet disa rregulla që prindërit duhet t'i udhëzojnë fëmijët e tyre për një lundrim sa më të sigurt në Internet.

Kjo iniciativë u mbështet edhe nga Ofruesit e Shërbimit të Internetit në Shqipëri, të cilët e shpërndanë mesazhin në rrjetet e tyre sociale dhe dyqanet fizikë.

Ky poster është krijuar në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me Unionin Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU), pjesë e programimit global të ITU-së për mbrojtjen e fëmijëve në internet

Tregoni kujdes me shpërndarjen e të dhënave personale online!

- MËSOJINI FËMIJËVE RËNDËSINË E FJALËKALIMEVE TË FORTA**
Udhëzoni fëmijët të sigurojnë illogaritë e tyre me fjalëkalime të forta që mbartin kombinime numrash, karaktere speciale dhe shkronja të vogla/të mëdha
- EDUKOJINI PËR ZBATIMIN E NJË RUTINE TË SIGURT NË INTERNET**
Fëmijët duhet të dinë se një i huaj në internet paraqet një rrezik! Ata duhet të shmangin bisedën me persona të huaj në çdo platformë online
- KUFIZONI PËRDORIMIN E INTERNETIT PËR FËMIJËT**
Koha e zgjatur para ekranit mund të sjellë rreziqe të ndryshme në internet. Kufizoni përdorimin e pajisjes së fëmijës tuaj me programe të kontrollit prindëror
- BËHUNI PJESË E MARRËDHËNIES SË FËMIJËS ME BOTËN ONLINE**
Mënyra më e zgjatur për të garantuar sigurinë e fëmijës tuaj në internet është duke qenë pjesë e aktiviteteve të tij në internet
- NDËRGJEGJËSOJINI FËMIJËT PËR KËRCËNIMET E MUNDSHME QË MUND TË HASIN NË INTERNET**
Ndërgjegjësimi i fëmijëve për rreziqet e ndryshme në internet mund të jetë këshilla më e mençur e sigurisë në internet për fëmijët në botën e sotme
- TRAJNOJINI FËMIJËT PËR TË KLIKUAR ME KUJDES!**
Edukoni fëmijët që të mos klikojnë në linqe të panjohura. Mësojini të qëndrojnë larg çdo platforme që automatikisht të drejton në faqe të tjera
- MOS HARRONI SE ASPEKTET POZITIVE TË INTERNETIT I TEJKALOJNË ATO NEGATIVE**
Interneti është një burim i shkëlqyer mësimor dhe argëtesues për fëmijët. Inkurajoni fëmijën tuaj të eksplorojë internetin në potencialin e tij të plotë

RAPORTO PËRMBAJTJE TË PALIGJSHME/DËMSHME
Ky shërbim ka si qëllim t'u vijë në ndihmë fëmijëve dhe të rinjve për raportimin e përmbajtjeve të paligjshme/dëmshme të hasura gjatë lundrimit në internet. Raportimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë nga Autoritetet Përgjegjëse për të bërë vlerësimin e rastit, si dhe për të marrë masa të menjëhershme. Për të bërë raportimin tuaj, përdorni linkun më poshtë:
https://cesk.gov.al/permbajtje_te_paligjshme.html

Klikoni në link-un më poshtë për t'u njohur me më shumë burime mbi navigimin në mënyrë të sigurt të fëmijëve në internet nga ITU:
<https://www.itu-cop-guidelines.com/children>